



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**NJOFTIM PËR MEDIA**

Ditën e enjte, në datën 9 mars 2023, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive, (AMA) u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

<b>Armela</b>	<b>KRASNIQI</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Desada</b>	<b>METAJ</b>	<b>Zëvendëskryetar</b>
<b>Aurela</b>	<b>BICJA</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Besian</b>	<b>ZOGAJ</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Gjergji</b>	<b>HAMITI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Jetmir</b>	<b>HALILAJ</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Joana</b>	<b>ALLUSHI</b>	<b>Anëtar</b>

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Zgjerimin e zonës së licencimit të shoqërisë “STAR NEWS-RTV” sh.p.k. për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv “TV Star Plus”, në allotmentin Lezhë (**Vendimi nr. 9 , datë 09.03.2023**).
2. Rrëzimin e aplikimit të shoqërisë “Albanian Media” sh.p.k., me NIPT: L91303013I, për marrje autorizimi për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv, online mbështetur në rrjet IP (OTT) “Info 24”, për shkak të mangësive të konstatuara në dokumentacion (**Vendimi nr. 10 , datë 09.03.2023**).
3. Pranimin e kërkesës së subjektit person fizik Adriatik Bajrami, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor “TV Kabllor Delvina”, për reduktimin e zonës së ofrimit të shërbimit nga zona “*Njësia administrative Delvinë dhe Bashkia Finiq*” në “*Njësitë administrative Delvinë dhe Finiq*” (**Vendimi nr. 11, datë 09.03.2023**).
4. Pranimin e kërkesës së shoqërisë “Tv Kabllor Vlora Cable” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor “TV Kabllor Vlora Cable”, për reduktimin e zonës së ofrimit të shërbimit, duke hequr dorë nga “*Njësia administrative Himarë*” (**Vendimi nr. 12, datë 09.03.2023**).
5. Pranimin e kërkesës për reduktimin e zonës së ofrimit të shërbimit të subjektit person fizik Gentian Biçiku, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor “TV Kabllor M&G”, duke hequr dorë nga zona e ofrimit “*Njësia administrative Tregan*” (**Vendimi nr. 13, datë 09.03.2023**).

6. Konstatimin e pavlefshmërisë së licencës së shoqërisë “MRM” sh.p.k., për subjektin audioviziv privat “TV LOBI” (**Vendimi nr. 14 , datë 09.03.2023**).
7. Pranimin e kërkesës së shoqërisë “Abc News” sh.a., licencuar për subjektin audioviziv privat “ABC NEWS” dhe për subjektin audio “ABC NEWS”, për ndryshimin e logos së transmetimit (**Vendimi nr. 15 , datë 09.03.2023**).
8. Rinovimin e licencës së shoqërisë “Radio Ime” sh.p.k., për subjektin audio privat vendor “Radio Ime”, me zonë ofrimi shërbimi “*Bashkitë Tiranë, Durrës, Kamëz, Shijak, Vorë*” (**Vendimi nr. 16 , datë 09.03.2023**).
9. Rinovimin e licencës së shoqërisë “DYNAMICSOUND” sh.p.k., për subjektin audio privat rajonal “Radio One” dhe pranimin e disa prej kërkesave të subjektit për ndryshime të kushteve teknike të licencës (**Vendimi nr. 17, datë 09.03.2023**).
10. Ndryshimin e formës së organizimit të subjektit tregtar nga person fizik Shkëlqim Hajno, në shoqërinë “RADIO SARANDA” sh.p.k., rinovimin e licencës së subjektit audio privat “Radio Saranda” dhe ndryshimin e zonës së licencimit nga “*Bashkia Sarandë*” në “*Bashkia Sarandë, Njësitë administrative Aliko, Finiq dhe Mesopotam*” (**Vendimi nr. 18 , datë 09.03.2023**).
11. Pranimin e kërkesës së shoqërisë “ONE ALBANIA” sh.a., autorizuar për ofrimin dhe përsëritjen e shërbimeve të programit audioviziv, online mbështetur në rrjet (IPTV), (OTT) dhe “Info Channel”, për ndryshimin e emrit të subjektit tregtar nga shoqëria “One Telecommunications” në “ONE ALBANIA” (**Vendimi nr. 19 , datë 09.03.2023**).
12. Shtyrjen e shqyrtimit të ankimit administrativ të shoqërisë “Tibo” sh.p.k., për subjektin OSHMA “Tibo”, lidhur me vendimin nr. 14 datë 29.09.2022 për dënimin me gjobë, në masën 2 000 000 (dy milion) lekë, për mbledhjen e ardhshme të AMA-s.

## AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 9 mars 2023